

WIKIDATA



Wikidata (<http://wikidata.org>) është një bazë e lirë të dhënash bashkëpunuese, shumëgjuhëshe dhe dytësore, që mbledhë të dhëna të strukturuar për të siguruar mbështetje për **Wikipedia**, **Wikimedia Commons**, projektet tjera wiki nga **Fondacioni Wikimedia** dhe për këdo tjetër në botë.

Çfarë do të thotë kjo?

E lirë - Të dhënat në Wikidata publikohen nën në domenin publik, duke lejuar ripërdorimin e të dhënave në shumë skenarë të ndryshëm. Ju mund të kopjoni, modifikoni, shpërndani dhe të përdorni të dhënat, madje edhe për qëllime komerciale, pa kërkuar leje.

Bashkëpunuese - Të dhënat futen dhe mbahen nga redaktorët e Wikidata-s, të cilët vendosin mbi rregullat e krijimit dhe menaxhimit të përmbajtjes. Robotët Bots përdorën gjithashtu për të futur të dhëna në Wikidata.

Shumëgjuhëshe - Redaktimi, konsumimi, shfletimi dhe ripërdorimi i të dhënave është në dispozicion në shumë gjuhë. Të dhënat e futura në çdo gjuhë janë menjëherë të disponueshme në të gjitha gjuhët e tjera. Redaktimi në çdo gjuhë është i mundur dhe i inkurajuar.

Një bazë dytësore e të dhënave - Wikidata regjistron jo vetëm deklarata, por edhe burimet e tyre, dhe lidhjet me bazat e të dhënave të tjera. Kjo reflekton diversitetin e njohurive në dispozicion dhe mbështet nocionin e verifikueshmërisë.

Mbledhja e të dhënave të strukturuar - Zbatimi i një shkalle të lartë të organizimit të strukturuar lejon ripërdorimin e lehtë të të dhënave nga projektet e Wikimedia-s dhe palëve të treta, dhe mundëson që kompjuterët t'i përpunojnë dhe "kuptojnë" ato.

Mbështetje për projektet wiki - Wikidata ndihmon Wikipedia-n me kuti informacioni më të lehtë për t'u ruajtur dhe lidhje me gjuhë të tjera, duke reduktuar kështu ngarkesën e redaktimit dhe përmirësuar cilësinë. Përditësimet në një gjuhë janë në dispozicion për të gjitha gjuhët e tjera.

Çdokush në botë - Çdokush mund të përdorë Wikidata-n në mori mënyrash të ndryshme duke përdorur ndërfaqen e sajtit <http://wikidata.org>.

Si funksionon Wikidata?

Wikidata është një depo qendrore e të dhënave që mund të përdoret nga të gjithë, duke përfshirë projektet tjera wiki të mbështetura nga Fondacioni Wikimedia. Përmbajtja e ngarkuar në mënyrë dinamike nga Wikidata nuk ka nevojë të mirëmbahet në çdo projekt individual wiki. Për shembull, statistikën, datat, vendet dhe të dhënat e tjera të përbashkëta mund të centralizohen në Wikidata.

Një **artikull** përshkruhet nga një sërë **deklarata**, secila duke pohuar një të **dhënë ose fakt** të vetëm për të.


Një **tipar** është një lloj specifik **informacioni**, siç është një fushë në një formular, dhe përdoret për të **përshkruar** se çfarë do të thotë e dhëna.


WIKIDATA


Deklaratat kanë këtë formë:

Statement = Item (Q) --> Property (P) --> Value

Deklarata = Njësia (Q) --> Tipari (P) --> Vlera

 Njësia (Q) mund të jetë çdo gjë (artikull i Wikipedias, gjë, person, vend, koncept, etj.)

 Tipari (P) është një lloj i veçantë i vetëm i të dhënës që përshkruan këtë njësi (p.sh. lartësia e malit, kryeqyteti i një vendi, gjinia e personit)

 Vlera është ose një referencë e një njësie (Q) tjetër (p.sh. kryeqyteti i Gjermanisë është Berlino) ose një vlerë e saktë (p.sh. lartësia e Himalajeve është 8848 metra)

etiketa
(label)

Douglas Adams (Q42) identifikuesi i njësisë (item identifier)

Shkrimtar dhe humorist Anglez

Douglas Noël Adams | Douglas Noel Adams

Emërtimet (aliases)

[▶ Më shumë gjuhë \(In more languages\)](#)

përshkrimi
(description)

Deklaratat(Statements)

educated at (property)

tipari (property)

rradhitja (rank)

grupi i deklaratave (statement group)

St John's College (value)

end time	1974
academic major	English literature
academic degree	Bachelor of Arts
start time	1971

Kualifikuesit (qualifiers)

2 references (opened references)

stated in	Encyclopædia Britannica Online
reference URL	http://www.nndb.com/people/731/000023662/
original language of work	English
retrieved	7 December 2013
publisher	NNDB
title	Douglas Adams (English)

+ add reference

Brentwood School (collapsed references)

end time	1970
start time	1959

0 references

+ add (statement)